



Prishtinë: 30.03.2011

Kodi i ZRRE-së: V\_352\_2011

Nr.i Referencës: ZRRE/DMK\_V\_515\_01\_11

### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 17 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_515\_01\_11**;
5. Apelimi i KEK-ut me datë 14.03.2011;
6. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;

**Në mbledhjen e mbajtur më 30 mars 2011 nxori këtë:**

#### VENDIM

**REFUZOHET** apelimi i KEK-ut për ankesën e konsumatorit Ylli Morina (shifra e konsumatorit DPR – 90036856) nga Prishtina, si në arsyet e paraqitura të këtij vendimi.

#### Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 27.02.2009 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 24.02.2009 lidhur me kontestimin e faturës 12/2007 dhe 01/2008.

- Me datë 12.01.2008 KEK-u i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike me 3480 kWh, apo e shprehur në vlerë financiare 235.94 €.  
**Provë:** Fatura e muajit 12/2007
- Me datë 09.02.2008 KEK-u i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike me 4586 kWh, apo e shprehur në vlerë financiare 309.48 €.  
**Provë:** Fatura e muajit 01/2008
- Me datë 06.02.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori kanë dalë tek konsumatori dhe kanë bërë ndërrimin e njësorit elektrik, ku kanë hequr nga matja njehsorin elektrik nr. 36242427 dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik me nr. 40862304.  
**Provë:** Vërtetimi mbi ndërrimin e njësorit elektrik nr. 002547 i datës 06.02.2008
- Konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për konsumator në KEK duke kundërshtuar faturën e muajit 12/2007 dhe muajit 01/2008.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit
- Me datë 24.02.2009 Departamenti për Konsumator në KEK iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke u thirrur në procesin e ndërrimit të njësorit elektrik nr. 002547 datë 06.02.2008 dhe procesit nga qendra e kalibrimit nr. 001488 datë 25.04.2008.  
**Provë:** Përgjigja e KEK-ut e datës 25.03.2009



- Me datë 27.02.2009, konsumatori ka apeluar përgjigjur e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së
- Me datë 31.01.2011 DMK ka lëshuar vendimin nr. ZRRE/DMK\_V\_515\_01\_11 dhe duke u bazuar në analizat e bëra ka vendosur që të **aprovtojë pjesërisht** ankesën e KEK dhe ka arritur në përfundim se:
  1. KEK-u duhet që konsumatorin me shifër DPR – 90036856 të shkarkoj për faturat e energjisë elektrike të KEK-ut për periudhën 12/2007 dhe 01/2008.
  2. Pasi që për këto periudha vërehet se konsumatori ka bërë shpenzim të energjisë atëherë KEK-u duhet që për periudhën 12/2007 dhe 01/2008 të faturoj konsumatorin me shpenzimin e bërë gjatë periudhës 12/2006 dhe 01/2007.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: ZRRE/DMK\_V\_515\_01\_11 dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së. Apeluesi (KEK-u) nuk ka ofruar ndonjë dëshmi shtesë kundër këtij Vendimi, andaj Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë** apelimin KEK-un për arsyet e paraqitura në vendimin e DMK. Bordi i ZRRE-së ka vendosur që vendimi i DMK-së: **ZRRE/DMK\_V\_515\_01\_11** të mbetet në fuqi.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

#### Bordi i ZRRE-së

---

Dr. Ali Hamiti, kryesues

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar